



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**

**Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor**

Mbledhja nr. 38

Prishtinë, më 3.3.2009, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

**PROCESVERBAL**  
**nga mbledhja e Komisionit**

Në mbledhje **morën pjesë**: Lulzim Zeneli, Zulfi Merxha, Naim Maloku, Myrvete Pantina, Hestet Cakolli, Elhëme Hetemi, Ali Lajçi, Berat Luzha, Zef Morina.  
Munguan : Dragisha Miriç, Selvie Halimi.

**Të ftuarit** dhe pjesëmarrësit tjerë : zyrtarët nga MBPZHR: Fadil Musa dhe Isah Rudaku, nga MMPH nga OSCE Blerim Vela dhe Maria Berishaj.

**Nga stafi mbështetës** i komisionit : Bajram Badivuku

Mbledhjen e kryesoi : **Lulzim Zeneli**, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i projektligjit për bujqësinë dhe zhvillimin rural,
3. Shqyrtimi i projektligjit për Rrezatimin jonizues.

**Kryesuesi Lulzim Zeneli** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes, hapi mbledhjen për pikat e rendit të ditës.

**1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar**

**Kryesuesi** konstatoi miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

**2. Shqyrtimi i projektligjit për bujqësinë dhe zhvillimin rural**

**Lulzim Zeneli** ftoi anëtarët e komisionit dhe zyrtarët e MBPZHR për shqyrtim të nenit 29, përkatësisht vërejtjet e grupit punues, ndaj u miratuan amendamentet si vijon:

Te **Neni 2** të shtohet përkufizimi :

**Agjencioni i pagesave** nënkupton organizatën publike buxhetore e cila ka statusin e personit juridik në kuadër të ministrisë, e themeluar me këtë ligj.

## **Amendamenti 11**

Të shtohen pas Nenit 6 (në fillim të kapitullit III) :

### **Neni i ri Financimi**

**Financimi për politikat bujqësore dhe të zhvillimit rural bëhet nga:**

- Buxheti i Republikës së Kosovës,
- Donacionet dhe
- burimet tjera në përputhje me ligjet në fuqi.

### **Neni i ri Përfituesit nga masa mbështetëse**

**Përfituesit nga fondi i programit nëpërmjet masave, të cilat ndërmerren në kuadrin e politikës së bujqësisë dhe të zhvillimit rural janë fermerët, grupet e fermerëve, personat fizik apo juridik të cilët zhvillojnë aktivitete në sferën e bujqësisë dhe zhvillimit rural;**

### **Neni i ri Aplikimet**

- 1. Aplikimet për të përfituar fonde nga masat mbështetëse për politikat bujqësore dhe të zhvillimit rural mund të paraqiten nga një fermer, grup fermerësh, personat fizik apo juridik siç parashikohet me këtë ligj.**
- 2. Përfituesit duhet t'i përdorin fondet në përputhje me qëllimin për të cilin ato janë dhënë.**

### **Neni i ri Pagesa e mjeteve**

**Pagesa e mjeteve për zbatimin e politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural bëhet nga Agjencia e Pagesave për zhvillimin e bujqësisë dhe zhvillimin rural.**

### **Neni i ri Dokumentet që duhen mbajtur**

- 1. Përfituesit të cilët kanë marrë fonde nga masat mbështetëse duhet të mbajnë për një periudhë 4 vjeçare në vijim, duke filluar nga data e lëvrimit të fondit, dokumentacionin i cili është përdorur për përfitimin e fondeve,.**
- 2. Dokumentacioni që duhet mbajtur nga përfituesit përcaktohet me akt nënligjor nga Ministria.**

### **Neni i ri Agjencia e Pagesave**

- 1. Agjencia e Pagesave themelohet si organizatë publike buxhetore, e cila ka statusin e personit juridik publik në kuadër të ministrisë, e themeluar me këtë ligj.**
- 2. Agjencia e Pagesave ka kompetencat e mëposhtme:**
  - a) zbatimin e masave të politikës bujqësore dhe të zhvillimit rural;
  - b) hartimin e raporteve dhe të analizave në përputhje me zhvillimin e bujqësisë;
  - c) ngritjen dhe funksionimin e sistemeve të integruara të administrimit dhe të kontrollit;
  - d) ngritjen dhe implementimin e sistemeve të informimit të tregut;
  - e) krijimin dhe mirëmbajtjen e bazës së të dhënave të nevojshme;
  - f) implementimin e masave të kontrollit dhe auditit të brendshëm;
  - g) inspektimin e fermerëve dhe subjekteve që kanë përfituar nga fondet e programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural.

3. Agjencia e Pagesave zbaton programe të mbështetjes ndërkombëtare për bujqësinë;
4. Organizimi, mënyra e funksionimit, emërimi, lirimi ose shkarkimi i Udhëheqësit të Agjencisë së Pagesave si dhe mënyra e rekrutimit të punonjësve, përcaktohet nga Ministria.

Të shtohen para Kapitullit X :

**KREU i ri**  
**Inspektimi**  
**Neni i ri**  
**Mbikëqyrja**

Implementimin dhe inspektimin e këtij ligji e bën Ministria. Sipas dispozitave të këtij ligji inspektimin do ta bëjnë inspektori bujqësor, inspektori i veterinars dhe sigurisë së ushqimit në kuadër të përgjegjësive të përcaktuara me ligj.

**Neni i ri**

Rastet e kundërvajtjeve administrative dhe sanksionet administrative  
Shkeljet e mëposhtme, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative:

1. Mos mbajtja e dokumentacionit të përdorur për përfitimin e fondeve për një periudhë 4 vjeçare.
2. Për kundërvajtjen administrative të përcaktuar sipas pikës 1 të këtij neni, inspektori vendos gjobë në masën 100-300 euro.

## **Amendamenti 12**

Neni 29, riformulohet :

1. Kundër vendimit të inspektorit mund të paraqitet ankesë me shkrim të Udhëheqësit të inspekcionit përkatës në afat prej 15 ditësh, i cili brenda 30 ditësh duhet të jap përgjigjen me shkrim parashtruesit të ankesës.
2. Kundër vendimit të Udhëheqësit të inspekcionit përkatës , pala mund të paraqesë ankesë në Gjykatën kompetente në afat prej 30 dite.

Të shtohet pas kreut X :

**KAPITULLI i ri**  
**DISPOZITAT NDËSHKIMORE**

**Neni i ri**  
**Kundërvajtjet**

1. Për kundërvajtje me gjobë prej 1000 deri 5000 euro dënohet personi që :
  - 1.1. Nuk i përdor fondet për qëllimet e destinuara si përfitues në pajtim me nenin 8.2. të këtij ligji.
  - 1.2. Nuk ruan dhe nuk i paraqet personit të autorizuar dokumentacionin në periudhën katër (4) vjeçare sipas nenit 9.1 të këtij ligji.
  - 1.3. Pengon personin e autorizuar për kryerjen e inspektimit sipas nenit 21.3 të këtij ligji.

**Neni i ri**

Të gjitha pagesat që rrjedhin nga aplikimi i dispozitave ndëshkuese të këtij ligji si dhe të hyrat tjera nga taksat, derdhen në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## **Amendamenti 13**

Neni 30, paragrafi 1, numri 18 bëhet 12, ndërsa në paragrafin 2 “dy (2) vjetësh” zëvendësohet me “12 muaj”.

## **2. Shqyrtimi i projektligjit për Rrezatimin Jonizues**

**Lulzim Zeneli** falënderoi grupin punues për shqyrtimin e dy projektligjeve të cilat janë në rend dite në mbledhjen e sotme, udhëhequr nga **Naim Maloku**. Pas shqyrtimit të rekomandimeve të GP, komisioni miratoi si vijon:

### **Amendamenti 1**

**Titulli i Projektligjit**, riformulohet :

**Ligjin për Mbrojtje nga Rrezatimi Jo-jonizues, Jonizues dhe Sigurinë Nukleare**

### **Amendamenti 2**

**Preambula e projektligjit**, riformulohet :

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me qëllim të rregullimit ligjor të rrezatimit jo-jonizues, jonizues dhe sigurisë nukleare,

### **Amendamenti 3**

Neni 3, pas pikës 3, shtohet përkufizimi si vijon :

**AMRK – Agjencioni për mbrojtjen nga rrezatimet i Kosovës.**

Pas pikës 17, shtohet përkufizimi si vijon:

**18. Personeli-është kuadri profesional që ka kryer specializimin e radiologjisë, radioterapisë, mjekësisë nukleare dhe aftësimet përkatëse subspecialistike për punë në zona me rreze jonizuese dhe jo-jonizuese me licencim përkatës.**

### **Amendamenti 4**

Neni 4, fjalët “përgjegjësi qytetare” zëvendësohet me fjalët “përgjegjësi civile”.

### **Amendamenti 5**

Neni 5, nën-paragrafi 1.3, fjala “implementim” zëvendësohet me fjalën “zbatim”. Ndryshimi vlen për tërë tekstin e projektligjit ku përsëritet kjo fjalë.

### **Amendamenti 6**

Pas kapitullit II shtohet kapitulli i ri (III) me titull : **THEMELIMI I AUTORITETIT RREGULLATIV**, më tutje neni i radhës i këtij kapitulli fillon me titullin e nenit “**Agjencioni për Mbrojtjen nga Rrezatimet i Kosovës-AMRK**”.

### **Neni i ri**

1. Në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapsionor themelohet **Agjencia për Mbrojtjen nga Rrezatimet i Kosovës-AMRK**, si autoritet kompetent qendror që mbikëqyr dhe siguron zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet.

2. AMRK kryesohet nga kryeshefi i cili emërohet nga Kryeministri me një mandat 4 (katër) vjeçar.

3. Ministria miraton strukturën e AMRK-së si dhe i siguron burimet e nevojshme financiare dhe njerëzore për zbatimin e detyrimeve ligjore.

### **Neni i ri**

Detyrat e AMRK-së :

a) harton rregulloret dhe udhëzimet dhe aktet e praktikave të mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese, sigurinë dhe sigurimin bërthamor, të cilat janë të detyrueshme për zbatim nga të gjithë personat fizikë e juridikë,

b) kontrollon zbatimin e akteve ligjore e nënligjore për mbrojtje nga rrezatimi,

c) pajis me licencë subjektet që kryejnë veprimtaritë e parashikuara në këtë ligj. Licenca sigurohet nga Ministri,

ç) drejton nga ana teknike të gjitha autoritetet kombëtare dhe lokale për zbatimin e menjëhershëm të masave të nevojshme për zbutjen e efekteve të akcidenteve radiologjike ose bërthamore.

d) jap rekomandime dhe propozime për përmirësimin e legjislacionit në fuqi në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet.

dh) miraton standardet e sigurisë, sigurimit dhe mbrojtjen nga rrezatimet.

e) bashkëpunon me organizmat kombëtarë e ndërkombëtarë për problemet e mbrojtjes nga rrezatimet.

ë) bashkërendon punën me institucionet e specializuara brenda dhe jashtë vendit, për kalibrimin e pajisjeve të rrezatimit jonizues, dozimetrinë personale, monitorimin e mjedisit, për kontrollin mjekësor të punonjësve të ekspozuar profesionalisht, trajnimin e personelit, si dhe me institucione të tjera, sipas nevojave, në bazë të marrëveshjeve të mirëkuptimit për zgjidhjen e problemeve kombëtare në fushën e mbrojtjes nga rrezatimi.

f) bashkëpunon me Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe inspektoriatin e Mjedisit.

g) mban inventarin kombëtar të burimeve të rrezatimit jonizues, jo-jonizues, materialeve bërthamore dhe personelit të angazhuar me këto burime.

i) mbledh informacion dhe kryen matjet e analizat bazë për kontrollin e mbrojtjes nga rrezatimet, sigurinë dhe sigurimin.

j) kryen inspektimin e instalimeve rrezatuese.

## **Neni i ri**

**Aktet Nënligjore për mbrojtjen nga rrezatimi jo-jonizues, jonizues dhe sigurisë nukleare si dhe për sigurinë e burimeve të rrezatimit jonizues, me propozim të AMRK-së, miratohen nga Qeveria e Kosovës.**

### **Amendamenti 7**

Neni 12, pas paragrafit 1 shtohet paragraf i ri :

**2. Qeveria me akt nënligjor të veçantë përcakton kufizimin e dozave, kohën e ekspozimit dhe orarit të punës të personelit dhe pacientëve për mbrojtjen nga rrezatimi jonizues.**

### **Amendamenti 8**

Neni 12, në paragrafin 2, fjalia “ Ministria përshkruan.....” ndryshohet në “ **Ministria përcakton.....**”.

### **Amendamenti 9**

Neni 24, fshihet.

### **Amendamenti 10**

Neni 39, paragrafi 2, riformulohet si vijon :

**2. Personi juridik nga paragrafi 1. i këtij neni, nxjerrë rregullore të brendshme për masat e mbrojtjes fizike të objektit nuklear, materialit nuklear dhe mbeturinave radioaktive.**

### **Amendamenti 11**

Neni 40, fshihet paragrafi 7.

### **Amendamenti 12**

Neni 50, paragrafi 1 zëbërthehet në dy paragrafe me riformulim si vijon :

**1. Inspektorët të cilët kryejnë punët nga neni 48, paragrafi 1, i këtij ligji, duhet të kenë shkallën e caktuar të përgatitjes profesionale nga lëmi i fizikës inxhinierike, fizikës dhe kimisë.**

**2. Ministria nxjerr akt nënligjor me të cilin përcakton nivelet profesionale për ushtrimin e mbikëqyrjes sipas nenit 48 të këtij ligji.**

Paragrafi 2 shndërrohet në paragrafin 3.

## Amendamenti 13

Neni 56, paragrafi 1, riformulohet :

1.Me të holla në shumë prej 300 deri 900 Euro do të gjobitet personi fizik, ndërsa personi juridik prej 1000 deri 3000 nëse:

## Amendamenti 14

Neni 58, riformulohet :

**1. Ministria përmes inspektoratit, mbikëqyr dhe obligon shfrytëzuesit e objektit nuklear dhe shfrytëzuesit e tjerë të burimeve të rrezatimit jonizues që të sigurojnë kushte për vendosje dhe depozitim të mbeturinave radioaktive në afat prej dy vjetësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.**

## Të ndryshme

**Berat Luzha** theksoi se kryeshefi i AKP Muzafer Luma kërkon një takim me këtë komision lidhur me rekomandimet e seancës plenare rreth pyjeve, ndaj sugjeroi që komisioni ta vizitoi AKP por edhe dy ministrinë tjera në kuadër të veprimtarisë së këtij komisioni.

**Naim Maloku** konkretizoi kërkesën e Berat Luzhës duke theksuar se në Kuvend është debatuar, ndaj është e udhës të shihet se çka kanë ndërmarr dy ministrinë , si për çështjen e Prevallës ashtu edhe për Pyje.

**Zef Morina** tha se këto shqetësime duhet të reflektohen duke monitoruar komisioni ligjet e miratuara, ndaj sugjeroi që komisioni të filloi me monitorimin e ndonjë ligji të miratuar nga këto dy ministri (MMPH dhe MBPZHR), për arsye se Rekomandimet e miratuara nga kuvendi vetëm kanë ndihmuar që të filloi një punë por jo edhe të përfundoi, ndërsa monitorimi do të ishte më gjithëpërfshirës në zbatimin e ligjit.

**Elhëme Hetemi** u pajtua se ky komision ka monitorua ligjin e parkut të Sharrit dhe atë për pyje, por nuk dihet se deri ku ka mbëri kjo punë, ndaj duhet të vazhdohet me zbatimin e rekomandimeve të seancës plenare duke vizituar dy ministrinë përkatëse.

**Lulzim Zeneli** theksoi se diskutimet e anëtarëve të komisionit janë të arsyeshme , mirëpo në anën tjetër problemet janë të grumbulluara dhe vështirë është të realizohet diçka në këtë drejtim, prandaj ishte i mendimit që ndoshta duhet të organizohet një takim. Ai propozoi që komisioni të jetë në kontakt dhe për javën e ardhshme të martën të vizitohet Ministria e Bujqësisë dhe AKP. Për kohën dhe agjendën , anëtarët e komisionit do të njoftohen.

**Kryesuesi** njoftoi komisionin se Komisionet kryesore kanë përfunduar shqyrtimin e dy projektligjeve : Parandalimi dhe kontrolli i integruar i ndotjes dhe Projektligjin për Shfrytëzimin, administrimin, mirëmbajtjen e ndërtesës në bashkëpronësi, ndaj ky komision në cilësinë e komisionit funksional, pas rishikimit të të gjitha vërejtjeve të deritashme lidhur me këto dy projektligje, pajtohet që të procedohen për leximin e dytë.

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 14,35, mbledhja e radhës do të mbahet atëherë kur të janë të gatshme vërejtjet rreth projektligjit për Biocide .

Kryetari i Komisionit,  
**Lulzim Zeneli**